

20110531466

L I G J PËR PLOTESIMIN E LIGJIT PËR AUTOMJETE

Neni 1

Në Ligjin për automjete ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numer 14/2008) në nenin 11 pika 1 pas alinës 7 shtohet aline e re 8, si vijon:

"- formen dhe permbajtjen e kërkesës dhe dokumentacionin e nevojshëm për leshimin e lejes për lejim veç e veç të automjetit nga neni 17 paragrafi (7) i këtij ligji;"

Neni 2

Në nenin 17, pas paragrafit (5) shtohen 19 paragrafe të rinj (6), (7), (8), (9), (10), (11), (12), (13), (14), (15), (16), (17), (18), (19), (20), (21), (22), (23) dhe (24), si vijojnë:

"(6) Për kërkesën nga paragrafi (3) i këtij neni, organi për miratim detyrohet që të veprojë në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

(7) Nëse organi për miratim nuk miraton leje për lejim veç e veç të automjetit, perkatesisht nuk miraton aktvendim për refuzimin e kërkesës në afatin nga paragrafi (6) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës ka të drejtë që në afat prej tri diteve të punës, të parashtrorje kërkesë në sekretarinë e drejtorit të organit për miratim-Byroja për Metrologji dhe drejtori të miratoje leje për lejim veç e veç të automjetit.

(8) Formën dhe permbajtjen e formularit të kërkesës nga paragrafi (7) i këtij neni, i percakton ministri i Ekonomisë.

(9) Drejtori i organit për miratim-Byroja për Metrologji, detyrohet që në afat prej pesë diteve të punës nga dita e parashtrimit të kërkesës nga paragrafi (6) i këtij neni, në sekretarinë e drejtorit të organit për miratim, të miratoje aktvendim me të cilin do të konstatoje se kërkesa për leshimin e lejes për lejim veç e veç të automjetit pranohet apo refuzohet. Nëse drejtori nuk ka sekretari kërkesa parashtrorhet në sekretarinë e selisë së organit për miratim-Byroja për Metrologji.

(10) Me kërkesën për leshimin e lejes për lejim veç e veç të automjetit, kerkuesi dorezon edhe kopje nga kërkesa nga paragrafi (6) i këtij neni.

(11) Nëse drejtori i organit për miratim-Byroja për Metrologji nuk miraton aktvendim në afatin nga paragrafi (9) i këtij neni, parashtruesi i kërkesës mund ta njoftojë Inspektoratin Shtetëror Administrativ në afat prej pesë diteve të punës.

(12) Inspektorati Shtetëror Administrativ detyrohet që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (11) i këtij neni, të kryejë mbikeqyrje në organin për miratim-Byrone për Metrologji nëse është zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri diteve të punës nga dita e mbikeqyrjes së kryer ta informojë parashtruesin e kërkesës për masat e ndërmarra.

(13) Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Administrativ pas mbikeqyrjes së kryer në pajtim me ligjin miraton aktvendim me të cilin e ngarkon drejtorin e organit për miratim-Byrone për Metrologji kompetent për leshimin e lejes për lejim veç e veç të automjetit që në afat prej dhjetë ditësh të vendosë për kërkesën e parashtruar, perkatesisht ta miratoje apo refuzojë kërkesën dhe ta njoftojë Inspektoratit Shtetëror Administrativ për aktin e miratuar. Me njoftimin dorezohet edhe kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesën e parashtruar.

(14) Nëse drejtori i organit për miratim-Byroja për Metrologji nuk vendos në afatin nga paragrafi (13) i këtij neni, inspektori do të parashtrorje kërkesë për ngritjen e procedurës kundervajtëse për kundervajtje të percaktuara në Ligjin për inspeksionin administrativ dhe do të percaktojë afat plotësues prej pesë diteve të punës, në të cilin drejtori i cili udhëheq organin do të vendosë për kërkesën e parashtruar për çfarë në afatin e njejtë do ta njoftojë inspektorin për aktin

e miratuar. Me njoftimin dorezohet edhe kopje nga akti me të cilin ka vendosur për kërkesen e parashtruar. Inspektori në afat prej tri diteve të punes e informon parashtruesin e kërkeses për masat e ndermarra.

(15) Nese drejtori i organit për miratim-Byroja për Metrologji nuk vendos edhe në afatin plotesues nga paragrafi (14) i ketij neni, inspektori në afat prej tri diteve të punes do të parashtroje kallezime te prokurori publik kompetent dhe në atë afat e informon parashtruesin e kërkeses për masat e ndermarra.

(16) Nese inspektori nuk vepron për njoftimin nga paragrafi (12) i ketij neni, parashtruesi i kërkeses në afat prej pese diteve të punes ka të drejte që të parashtroje kundershtrim në sekretarine e drejtorit të Inspektoratit Shteteror Administrativ. Nese drejtori nuk ka sekretari, kërkesa parashtrohet në sekretarine e selise së Inspektoratit Shteteror Administrativ.

(17) Drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ detyrohet që në afat prej tri diteve të punes nga dita e pranimit ta shqyrtoje kundershtrimin nga paragrafi (16) i ketij neni dhe nese konstaton se inspektori nuk ka vepruar për njoftimin e parashtruesit të kërkeses nga paragrafet (12) dhe (13) të ketij neni dhe/ose nuk parashtron kallezim në pajtim me paragrafet (14) dhe (15) të ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ do të parashtroje kerkese për ngritjen e procedures kundervajtese për kundervajtje të percaktuar në Ligjin për inspeksionin administrativ për inspektorin dhe do të percaktoje afat plotesues prej pese diteve të punes, në të cilin inspektori do të kryeje mbikeqyrje në organin për miratim-Byrone për Metrologji nese eshte zbatuar procedura në pajtim me ligjin dhe në afat prej tri diteve të punes nga dita e mbikeqyrjes së kryer ta informoje parashtruesin e kërkeses për masat e ndermarra.

(18) Në rastin nga paragrafi (17) i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ, menjehere, e më së voni në afat prej një dite pune, do të autorizoje inspektor tjetër që ta kryeje mbikeqyrjen menjehere.

(19) Në rastet nga paragrafi (18) i ketij neni, drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ në afat prej tri diteve të punes, e informon parashtruesin e kërkeses.

(20) Nese drejtori i Inspektoratit Shteteror Administrativ nuk vepron në pajtim me paragrafin (17) të ketij neni, parashtruesi i kërkeses mund të parashtroje kallezim te prokurori publik kompetent në afat prej tete diteve të punes.

(21) Nese drejtori i organit për miratim-Byroja për Metrologji nuk vendos në afatin nga paragrafi (15) i ketij neni, parashtruesi i kërkeses mund të ngrite kontest administrativ në gjykatën kompetente.

(22) Procedura në Gjykatën Administrative eshte urgjente.

(23) Akti nenligjor nga paragrafi (8) i ketij neni miratohet në afat prej 15 ditesh nga dita e miratimit të ketij ligji.

(24) Pas miratimit të aktit nenligjor nga paragrafi (8) i ketij neni, ai menjehere, e më së voni në afat prej 24 oresh publikohet në ueb faqen e organit për miratim-Byrose për Metrologji.

Neni 3

Akti nenligjor i parapare në nenin 1 të ketij ligji, do të miratohet në afat prej 30 ditesh nga dita e hyrjes në fuqi e ketij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonise".